

VENDIM
Nr. 41, datë 23.10.2024

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR
NDRYSHIMIN E NIVELIT TARIFOR TË SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS-
KANALIZIME ELBASAN SHA**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 539, datë 30.12.2021, “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime” (vendimi i KKRR-së nr. 539),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 23.10.2024, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Elbasan sh.a. për miratimin e ndryshimit të nivelit tarifor për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura,

KONSTATOI SE:

1. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR), me vendimin nr. 16, datë 28.4.2023, “Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Elbasan sh.a.”, ka licencuar Shoqërinë Rajonale UK Elbasan për ushtrimin e veprimtarisë së grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura për një afat 4-vjeçar.

2. Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Elbasan sh.a. me shkresën nr. 1496 prot., datë 28.6.2024, me lëndë “Kërkesë për ndryshimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura”, ka paraqitur kërkesën pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për rishikimin e nivelit tarifor për shërbimet ujësjellës-kanalizime.

3. Në zbatim të pikës 1 të nenit 10 të metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime, shoqëria rajonale UK Elbasan sh.a në aplikimin për ndryshim të nivelit tarifor duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesa zyrtare drejtuar ERRU-së për ndryshimin e tarifave për shërbimet ujësjellës-kanalizime dhe ITUN-së;

b) pasqyrat financiare të vitit paraardhës certifikuar nga një Ekspert Kontabël i Autorizuar;

c) modeli i aplikimit për nivelin e ri tarifor. Të gjitha tabelat e modelit paraqiten të printuara dhe të firmosura nga shoqëria dhe sipas formatit *Excel* të miratuar nga ERRU-ja;

d) organigramë dhe përshkrimet e punës së stafit sipas pozicionit të tyre;

e) aktmarrëveshjet e kredisë midis shoqërisë dhe institucioneve kredi dhënëse, në rast se shoqëria është financuar me hua dhe skema e planit mujor të shlyerjeve gjatë viteve të kaluara dhe viteve të ardhshme;

f) mendimin e pushtetit vendor për tarifën e propozuara të shprehura në vendimin përkatës dhe konfirmuar nga prefekti i qarkut për legjitimitetin e tij;

g) vendimi i Këshillit të Administrimit për miratimin e tarifave të propozuara;

- h) procesverbali i Seancave Dëgjimore me Publikun, sipas formatit të përcaktuar nga ERRU-ja;
- i) subvencionet e përfituara nga operatori dhe ato të nevojshme gjatë periudhës rregullatore të tarifave të propozuara;
- j) lejet ose autorizimet për përdorimin e ujit për shoqëritë UK lëshuar nga Këshilli i Basenit Ujor të shoqëruara me marrëveshjen ndërmjet shoqërisë UK-së dhe KBU-së për pagesën e tarifave për përdorimin e ujit;
- k) raport i detajuar për gjendjen teknike të sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura, në të cilën të përshkruhet inventari i aseteve në përdorim të shoqërisë me të dhëna teknike (përmasat, lloji i materialit, vitet e instalimit/ndërtimit), përfshirë dhe prioritetet për zëvendësimin e tyre. Ky material do të hartohet sipas formatit të përcaktuar nga ERRU-ja;
- l) relacion analitik ekonomik për vitin paraardhës, si dhe për periudhën rregullatore që kërkohet ndryshimi i tarifave, në të cilën shprehet qartë justifikimi dhe argumentet përkatëse dhe objektivat e shoqërisë për përmirësimin e treguesve të punës;
- m) në rast se shoqëria aplikon për tarifë shitjeje uji me shumicë, në kërkesën e saj për tarifa duhet të paraqesë: relacion teknik dhe ekonomik me llogaritjet e tarifës së shitjes së ujit me shumicë, miratimin e tarifës së kërkuar nga organet drejtuese si dhe akt marrëveshjet midis palëve shitës-blerës;
- n) të ketë shlyer detyrimet për pagesën rregullatore, sipas kontratës së nënshkruar midis ERRU-së dhe shoqërisë dhe, në rast të detyrimeve të prapambetura, të ketë shlyer sipas marrëveshjes së nënshkruar mes tyre për shlyerjen me këste të tyre;
- o) deklarata për vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave sipas nenit 26 dhe nenit 46 të kësaj metodologjie.

4. Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria rajonale UK Elbasan sh.a. është plotësuar sipas parashikimeve të pikës 1 të nenit 10 të metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i shoqërisë Rajonale UK Elbasan është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në vendimin e KKRR-së nr. 539, datë 30.12.2021, dhe kuadrin rregullator në fuqi:

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Elbasan sh.a., për miratimin e ndryshimit të nivelit tarifor për shërbimet ujësjellës-kanalizime.

2. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike për njoftimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Elbasan sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYETAR
Evis Shurdha